




REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA-KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL ASSEMBLY OF MUNICIPALITY SKUPŠTINA OPŠTINE
SKENDERAJ

Nr.
No. 01-052/01-0036829/24
Data.
Data. 05.08.2024



Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kososovo

Komuna Skenderaj

Opshtina Skenderaj

Municipality of Skenderaj

Raport i Komisionit vlerësues për
Vlerësimin e ofertave nga Shprehja e Interesit
nr. 01-463/02-0033949/24 dt. 18.07.2024

Komisioni Vlerësues i formuar nga Kuvendi Komunal me Vendimin nr. 01-020/01-0060455/23 i dt. 01.12.2023, pas shpalljes së njoftimit publik 01-463/02-0033949/24 në përputhje të plotë me dispozitat që rrjedhin nga Ligji nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe procedurave të përcaktuara me Rregulloren (QRK) nr. 09/2020 si dhe në bazë të Vendimit nr.01-463/01-0060450/23 paraprak të Kuvendit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të Pronës për 99(nënt)137dhjetë e nëntë) vite, me datë 05.08.2024 sipas datës të caktuar në Njoftimin për Shprehje Interesi nr. 01-463/02-0033949/24 u mbledh për të bërë hapjen e ofertave në prezencë të të gjithë anëtarëve të Komisionit dhe ofertuesve sipas procesverbalit nr. 01-463/01-0036829/24 i dt. 05.08.2024.

Në shprehjen e Interesit sipas njoftimit 01-463/02-0033949/24 kemi vetëm një ofertues.

Ofertuesi i vetëm që ka shpreh Interes për marrjen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës ngastra nr. 699-2 (nga ndarja kadastrale e 3000m2 merr nr. 699-4) me sipërfaqe prej 3000m2 nga sipërfaqja e përgjithshme prej 11232m2, në Zonen kadastrale Skenderaj është personi juridik Kompania "Ismet Commerce" N.T.SH. me nr. biznesi 810614538 , me pronar Ismet Mustafa Klinë e Poshtme.

Ofertuesi sipas ofertës me nr. protokolli 05-463/01-0036497/24 të dt. 01.08.2024 i ka ofruar Komunës së Skenderajt 21% nga sipërfaqja totale e ndërtimit të objektit afarist banesor P+7, duke u zotuar edhe për punësimin e 168 personave nga kjo veprimtari si nder kriteret kryesore.

Pas verifikimit të dokumenteve dhe konstatimit nga ana e komisionit se ofertuesi i plotëson të gjitha kriteret e caktuara në njoftimin e publikuar për shprehje interesi duke dhënë analizë për çdo kriter siç ka përfshirë: vlerën investive prej 2,700,000.0 euro (dy milion e shtatëqind mijë euro), punësimin e 168 punëtorëve, interesin/përfitimin ekonomik të Komunës ofrimi i 21% koncesion

të sipërfaqes së llogaritur nga m2 të ndërtimit të cilat do të llogaritën nga komisioni komunal i DUMA-së, rritjen e vlerës së pronës duke u zotuar se nga ndërtimi në fjalë në një pronë të pa ndërtuar dhe të pa shfrytëzuar do të kthehet në pronë me ndërtim, gjelbërim dhe park për fëmijë, si dhe dëshmia e pagesës së depozitit në vlerë prej 50 mijë euro.

Nga e gjitha që u tha më lartë komisioni në përbërje të 5 anëtarëve e shpall nga kjo shprehje interesi fitues ofertuesin e vetëm Ismet Commerce N.T.SH. me nr. biznesi 810614538 me pronar Ismet Mustafa.

1. Blerta Dobra- Geci, Kryesuesese

2. Ismet Aliu, anëtar,

3. Avdullah Geci, anëtar,

4. Dardan Shala, anëtar,

5. Milazim Mustafaj, anëtar.



Skenderaj, me dt. 05.08.2024.